



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 761/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e përfaqësuar nga Blerim Sallahu, për shkak të mos procedimit për verifikim dhe numërim të 20,550 pakove me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pasafatshme ankesa Anr.761/2019 i datës 05.03.2021, e paraqitur nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Blerim Sallahu, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, që të bëjë verifikimin dhe numërimin e 20,550 pakove me fletëvotime të dorëzuara me postë nga votuesit jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 05.03.2021, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, i përfaqësuar nga Blerim Sallahu, në të cilin subjekti politik në fjalë atakon rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të shpallur nga KQZ-ja me vendimin Nr. 860-2021 të dt.04.03.2021, dhe kërkon që KQZ-ja përmes Shërbimit të votuesve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, të kontrolloj dhe të verifikoj aplikacionet e dërguara përmes postës elektronike gjithsej 130,168 aplikacione, të rikthehen 22,591 pakot me fletëvotime nga jashtë, të cilat janë të refuzuara dhe të njëjtat të verifikohen sipas ligjit dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të urdhërojë KQZ-në për verifikim dhe numërim të 20,550 fletëvotimeve të kategorizuara si të refuzuara nga votuesit jashtë Kosove, të cilat janë pranuar me postë brenda afatit ligjor deri më 12 shkurt 2021 nga KQZ.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës, në këtë fazë të procesit zgjedhor, gjeti se, **Ankesa është e palejuar**, për këto arsye:

Paneli, vlerëson së në këtë fazë të procesit zgjedhor kur është dorëzuar ankesa në PZAP, me pretendime nga ankuesi, që të urdhërohet KQZ-ja, që të bëjë verifikimin dhe numërimin e

20,550 pakove me fletëvotime të dorëzuara me postë nga votuesit jashtë Kosovës, nuk mund të procedohet si ankesë e afatshme, sepse në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, i LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, përcaktohet se: “Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”, nga kjo rezulton se në këtë fazë të procesit zgjedhor që ndodhemi, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, me datë 04.03.2021, mund të parashtrihen ankesa në PZAP, vetëm për rezultatet e shpallura nga KQZ-ja. Me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, e me asnjë Rregull Zgjedhore, nuk parashihet mundësia që të konsiderohet e lejueshme një ankesë, që ka të bëjë me pakot e fletëvotimeve nga votuesit jashtë Kosove, të cilat pako të supozuara me fletëvotime, jo që nuk janë verifikuar dhe numëruar nga KQZ-ja, para rezultatit përfundimtar.

Paneli, vlerëson po ashtu që edhe nëse i referohemi nenit 106 paragrafi 1, të LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, në të cilin përcaktohet se: “KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”, nga kjo del se mund të paraqitet ankesa në PZAP vetëm ndaj vendimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve që i publikon KQZ-ja, pas përfundimit të të gjitha procedurave. Por nuk mund të jetë një ankesë e lejueshme në këtë fazë të procesit zgjedhor për një çështje që nuk ka ekzistuar apo për fletëvotime që nuk janë përfshirë me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja.

Vetë fakti se këto pako me fletëvotime nuk janë përfshirë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të shpallur nga KQZ-ja me datë 04.3.2021, dhe se ankesa në anenë tjetër parashtrihet për vendimet e KQZ-ës me të cilat është vendosur që pakot e tilla të mos pranohen për numërim dhe rezultat përfundimtar, rrjedh se ankesa është pas afatit, pasi që pas publikimit të rezultateve mund të goditet vetëm vendimi për rezultatet përfundimtarë dhe jo procesi i administrimit zgjedhor në QNR.

Nga arsyet e theksuar më lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.761/2021 më datë 06.03.2021

Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.